Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar - Primljeno Më/Dana 15-09-2017
Nr.i organ. Org.broj | Numri broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost
02-035/02-857

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr 28/2008, nenit 51 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04. 2011, dhe Kontratës nr. 556 të lidhur në mesë të Helvetas Swiss Intercooperation Kosovo, Komunës së Vitisë dhe Këshillit të Veprimit Rinor Lokal për projektin Aftësitë për Punësim Rural (APR), Kryetari i Komunës së bien këtë:

# V E N D I M
## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ 8.360,50€ KËSHILLIT TË VEPRIMIT RINOR LOKAL NË VITI

**I.**

Me këtë Vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë **NDAN** mjete financiare në shumë prej **8.360,50€** me shkronja ( tetëmijë e treqind e gjashtëdhjetë euro e pesëdhjetë cent), Këshillit të Veprimit Rinor Lokal në Viti, në emër të implementimit të kontratës numër 556 e lidhur në mesë Helvetas Swiss Intercooperation Kosovo, Komunës së Vitisë dhe Këshillit të Veprimit Rinor Lokal për projektin Aftësitë për Punësim Rural (APR).

**II**

Mjetet nga neni 1 i këtij Vendimi, sigurohen nga Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2017 nga fondi burimor 21, kodi për subvencione dhe transfere i Kryetarit të Komunës së Vitisë.

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi transferohen në llogari të KVRL nga Vitia. Obligohet kryetari i KVRL që të paraqes raport me shkrim për mjetet e shpenzuara nga neni 1 i këtij vendimi te Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

**III**

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Zyra e Thesarit e Komunës së Vitisë

**IV**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kryetarit të Komunës së Vitisë.

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË

Sokol Haliti

Vendimi u dorëzohet:

1. K.V.R.L.- Viti
2. Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
3. Zyrës së thesarit dhe
4. Arkivi